

Titulli i lëndës: Sigurimi i shëndetit

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë (Programi Inxhinieria e Ambientit)
Titulli i lëndës:	Sigurimi i shëndetit
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II/Sem III
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	Sipas orarit.
Mësimdhënësi:	Naim Jerliu
Të dhënat kontaktuese:	naim.jerliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Ky modul trajton temat e rëndësishme dhe qasjet metodologjike në fushën e shëndetit mjedisor. Ai mbulon agjentët specifikë (p.sh., agjentët mikrobikë, metalet toksike, pesticidet dhe rrezatimin jonizues dhe jojonizues) të sëmundjeve të lidhura me mjedisin. Ai eksploron konceptet, vlerësimin dhe kontrollin e ekspozimit ndaj hazardëve të shëndetit mjedisor, riskun e rezultateve të pafavorshme shëndetësore që rezultojnë nga ekspozime të tilla dhe marrëdhëniet midis ekspozimeve dhe pasojave shëndetësore.</p> <p>Më tej, lënda trajton aplikimet dhe fushat e shëndetit mjedisor: cilësinë e ujit, cilësinë e ajrit, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe ndryshimet klimatike/ngrohjen globale dhe çështje të tjera globale në shëndetin mjedisor. Lënda, gjithashtu, ua prezanton studentëve qasjet e mundshme në të ardhmen për të kontrolluar problemet kryesore të shëndetit mjedisor.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda synon të ofrojë njohuri bazë për shëndetin mjedisor, zbulimin e ndikimit negativ të faktorëve mjedisorë dhe sigurimin e masave mbrojtëse për shëndetin e njeriut. Këto vendosen në kontekstin e fushës shkencore multidisiplinare të shëndetit mjedisor si një komponent thelbësor i fushës më të gjerë të shëndetit publik.</p>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojë burimet dhe llojet kryesore të agjentëve mjedisorë. • Diskutojë bartjen dhe fatin e këtyre agjentëve në mjedis. • Përshkruajë se si këta agjentë ndërveprojnë me sistemet biologjike dhe mekanizmat me të cilët ata ushtrojnë efekte të pafavorshme shëndetësore. • Identifikojë dhe përcaktojë hapat në proceset e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. • Përshkruajë hapat në procesin rregullator për sa i përket vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut dhe identifikojë legjislacionin dhe rregullativën aktuale në lidhje me çështjet mjedisore. • Identifikojë boshllëqet e rëndësishme në bazën aktuale të njohurive në lidhje me efektet shëndetësore të agjentëve mjedisorë dhe identifikojë fushat e pasigurisë në procesin e vlerësimit të rrezikut. • Identifikojë qasjet e mundshme në të ardhmen për të kontrolluar problemet kryesore të shëndetit mjedisor.
--	---

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mesimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Punë praktike	/		
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	/		

Kollokuiume, seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	2	7	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet, etj.	1	6	6
Totali			75
Metodat e mësimdhënies:	Kursi zhvillohet nëpërmjet ligjëratave, me shembuj/studime rasti, detyra PBL (mësim i bazuar në probleme), diskutime në grup ndërveprues në klasë, punë me projekte /seminare/workshope, detyra shtëpie individuale dhe prezantime në grup. Përfshihen materiale mësimore tradicionale dhe të vetë-drejtuar, të bazuara në ueb.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja e rregullt / Aktiviteti në klasë / Ndërveprimi: 10% Seminare, prezantime të përgjigjeve për temën/aktivitetin: 10% Projekt/detyra individuale: 20% Provimi përfundimtar: 60% Detyrat do të vlerësohen në bazë të përmbajtjes, organizimit dhe cilësisë së shkrimit.		
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Robert H. Friis. Essentials of environmental health. Third edition. Burlington, MA: Jones & Bartlett Learning. (2019) • Howard Frumkin, Editor. Environmental Health: From Global to Local. Third Edition. John Wiley & Sons. (2016). • Frank R. Spellman, Melissa L. Stoudt. The handbook of Environmental Health. The Scarecrow Press, Inc. (2013) • Pollozhani A., Kendrovski V., Kocubovski M., Hoxha-Krasniqi S. Ekologjia humane me higjienë. Shkup, (2012) 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Health Reference Series. Environmental Health Sourcebook Fifth Edition. Detroit, MI: Omnigraphics, (2018) • Richard Crume (Ed.) Environmental Health in the 21st Century. From Air Pollution to Zoonotic Diseases. Santa Barbara, California : Greenwood. (2018) • Jerome Nriagu. (Ed. In Chief). Encyclopedia of 		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje: Mjedisi në rrezik. Ndikimi i njeriut në mjedis. Ndërveprimi mjedis-njeri. Ndikimi mjedisor tek njerëzit. Shëndeti dhe mjedisi. Faktorët e mjedisit.
Java 2:	Epidemiologjia e Mjedisit
Java 3:	Toksikologjia e Mjedisit. Ekspozimi, doza, përgjigja.
Java 4:	Politika dhe Rregullativa Mjedisore. Hazardet mjedisore dhe risqet shëndetësore. Vlerësimi i riskut dhe zhvillimi i politikave. Komunikimi i riskut.
Java 5:	Sëmundjet zoonotike dhe vektoriale
Java 6:	Metalet dhe elementet toksike
Java 7:	Pesticidet dhe kimikatet e tjera organike
Java 8:	Rrezatimi jonizues dhe jojonizues
Java 9:	Cilësia e ujit
Java 10:	Cilësia e ajrit. Ndotja e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm. Monitorimi dhe kontrolli i ndotjes së ajrit.
Java 11:	Mbeturinat e ngurta dhe të lëngshme. Mbeturinat komunale, industriale dhe të rrezikshme. Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme
Java 12:	Ndikimet shëndetësore të ndotjes akustike (zhurmat)
Java 13:	Shëndeti & siguria në punë
Java 14:	Çështjet globale në shëndetin mjedisor. Ndryshimet klimatike/Ngrohja globale.
Java 15:	Koncepti <i>Një Shëndet</i> .

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Celularët/telefonat dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose të ndezur me dridhje) dhe të mos ekspozohen gjatë orës së mësimit.
Kompjuterët laptopë dhe tabletët lejohen vetëm për përdorim të qetë; aktivitete të tjera si kontrollimi i postës elektronike personale ose shfletimi në internet janë të ndaluara.